

VENDIM
Nr.88, datë 6.8.2008

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “UNION EOLICA ALBANIA” SHPK

(Ndryshuar me vendimin nr. 64, datë 22.9.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pika 1, germa “a”, 8, si dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, 13, si dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.8.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Union Eolica Albania” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik, Kavajë,

Konstatoi se:

1. Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të “Union Eolica Albania” sh.p.k. ka nisur me marrjen e vendimit nr.62, datë 4.6.2008.

2. Ligji nr.9913, datë 5.5.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” nuk parashikon të ketë fuqi prapavepruese për aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Në lidhje me ndërtimin e këtij parku, shoqëria “Union Eolica Albania” sh.p.k., në aplikimin e saj për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike, e bazon studimin e prefizibilitetit në të dhëna historike të regjistruara të erës, të matura në lartësi të ndryshme nga ato në të cilat do të punojnë gjeneratorët.

4. Ligji për sektorin e energjisë elektrike parashikon në nenin 15 autoritetin e ERE-s për vendosjen e kushteve të çdo licence.

Për sa konstatuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Union Eolica Albania” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre me kusht zbatimin përveç sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike, edhe të zbatimit të kushteve të mëposhtme:

a) Kryerjen e një studimi fisibiliteti, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim i koston së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE brenda 12¹ muajve nga data e lëshimit të licencës dhe përpara fillimit të zbatimit të punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve.

b) Shoqëria “Union Eolica Albania” sh.p.k. duhet paraqesë pranë ERE-s marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara

^{1,2}Të shtyjë me 12 muaj, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, afatet e përcaktuara në pikën 1, germa “a” dhe “d” të vendimit nr.88, datë 6.8.2008 “Për licencimin e shoqërisë Union Eolica Albania sh.p.k.”

detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit.

c) Shoqëria “Union Eolica Albania” sh.p.k. do të respektojë detyrimet e shërbimit publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

d) Koha e zbatimit e të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu referuar datës së lëshimit të licencës, të jetë 36² muaj.

e) Mospërmbushja e pikave të mësipërme në afatet e përcaktuara e bën licencën të pavlefshme.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

^{1,2}Të shtyjë me 12 muaj, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, afatet e përcaktuara në pikën 1, germa “a” dhe “d” të vendimit nr.88, datë 6.8.2008 “Për licencimin e shoqërisë Union Eolika Albania sh.p.k.”